

# Statistikat afatshkurtra

## Shërbimet - Tremujori I, 2018


**Tiranë, më 20 Qershor 2018:** Treguesit tremujorë mbi shërbimet, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transport, Magazinim dhe Postë; Hotele; Informacioni dhe Komunikacioni; Aktivite të Arkitekturës dhe Inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

### Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Në tremujorin e parë 2018, këto tregues paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 1,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 8,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Tregti (%)




### Transport, Magazinim dhe Posta

Indekset e treguesve në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Posta, i cili përfshin transportin Hekurudhor të mallrave, Detar, Ajror, Magazinimin dhe aktivitetin Postar, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 10,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 0,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.


**Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Transport, Magazinim dhe Postë (%)**



### Hotele


Indekset e treguesve në aktivitetin Hotele, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 20,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 15,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 8,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Hotele (%)****Informacion dhe Komunikacion**

Indekset e treguesve në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, i cili përfshin aktivitetin e Publikimit, Telekomunikacionit si dhe shërbimet e Teknologjisë së Informacionit, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 1,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 4,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.


**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Informacion dhe Komunikacion (%)**

### Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike

Indekset e treguesve në aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike, i cili përfshin aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike, aktivitete të Kontrolleve dhe Analizave teknike, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënje 0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rënje 0,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rënje 0,1 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.


**Fig. 5 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Aktivitete Arkitekture dhe Inxhinierike (%)**



### Agjenci udhëtimi

Indekset e treguesve në aktivitetin Agjenci udhëtimi, në tremujorin e parë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënje 0,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rënje 2,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 0,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.

**Fig. 6 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Agjenci udhëtimi (%)****Tab. 1 Indeksi i Shitjeve neto në volum, Shërbime (2010=100)**

Sektioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
			Tr.I 2018 (2010=100)	I.18 / I.17 (%)	Tr. I 2018 (2010=100)	I.18 / IV.17 (%)
G	45+46	Tregti	120,1	1,6	137,4	1,5
H	49-53	Transport dhe Magazinim	41,3	10,4	49,3	22,9
I	55.1	Hotele	138,9	20,6	176,1	9,5
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	77,5	1,3	90,9	16,5
M	71	Aktivitete Arkitekturë dhe Inxhinierike	268,6	-0,8	246,0	15,4
N	79	Agjenci udhëtimi	194,9	-0,5	224,7	1,9

**Tab. 2 Indeksi i numrit të punësuarve dhe fondit të pagave, Shërbime (2010=100)**

Sektioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Të Punësuar		Fondi i pagave	
			Tr.I 2018 (2010=100)	I.18 / I.17 (%)	Tr. I 2018 (2010=100)	I.18 / I.17 (%)
G	45+46	Tregti	210,1	6,5	212,6	8,4
H	49-53	Transport dhe Magazinim	114,7	0,5	90,8	2,3
I	55.1	Hotele	127,5	15,4	141,3	8,7
J	58, 61, 62	Informacioni dhe Komunikimi	110,0	4,0	134,5	4,5
M	71	Aktivitete Arkitekturë dhe Inxhinierike	160,0	-0,3	195,8	-0,1
N	79	Agjenci udhëtimi	290,0	-2,9	333,5	0,2

# Shënimet metodologjike

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në Shërbime

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55,1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht,

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht  $2010=100$ . Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eleminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

### Përkufizimet e treguesve kryesorë

**Shitjeve neto** - Shitet neto përfshijnë shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

**Indeksi i Shitjeve neto** - Objektivi i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime.

**Numri i të punësuarve** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtar (përashtuar të vetëpunësuarit me pagesë),

**Indeksi i Numrit të punësuarve** - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuara.

**Paga dhe trajtime** - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërbimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

**Indeksi i fondit të pagave** - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtar, nga njëra periudhë në tjetrën.

### Përshtatja sezonale

**Përshtatja** sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2,1. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori I 2018. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave tremujore. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.